



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prinjen/Prudato Received/Delivry	22.03.2022	viti god year	
Organ /Njesia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtjela Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SAPN/JHM	1488/2022		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.148/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.148/2022 të datës 22.02.2022, të parashtruar nga ankuesja [redacted] kundër Vendimit me numër protokoli 16-161 të datës 15.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 22.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.148/2022 e datës 22.02.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] më datë 21.02.2022 ka parashtruar ankesë në formë elektronike në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar me datë 22.02.2022 më numër A.nr.148/2022, kundër Vendimit me numër protokoli 116-161 të datës 15.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtas materiale dhe vlerësimit jo drejt të provave materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës (tutje referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.02.2022 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Këshilli më datë 04.03.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e çështjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 22.02.2022 me numër protokoli 918/2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokoll 116-161 të datës 15.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal; Fotografi; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 24.02.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 04.03.2022; Vendimin e datës 11.01.2022 për caktimin e Zëvendësuese në pozitën Sekretare e Përgjithshëm në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal; Procesverbalet e Komisionit Disiplinor të datës 07.02.2022, 08.02.2022, 09.02.2022, 10.02.2022; Vendimin e datës 14.08.2022 për formimin e Komisionit Disiplinor; Vendimin e datës 13.01.2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr. 116-596 për formim të Komisionit Disiplinor; Emailin e datës 13.01.2022 nga [redacted] për ankuesen; Emailin e datës 13.01.2022 nga [redacted] Emailin e datës 13.01.2022 nga [redacted] për ankuesen; Emailin e datës 17.01.2022 nga [redacted] për [redacted] Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 22.04.2013 për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Shërbime të Përbashkëta; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 21.01.2014 për pozitën Zyrtar për Përkrahej dhe Sekretari; Akt Emërimi i datës 26.09.2014 për pozitën Zyrtar për Logjistikë; Akt Emërimin e datës 06.08.2014 për pozitën Vozitës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkesat e lëndës, konstatoi se ankesa e ankueses [redacted] është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës përkatësisht sipas Vendimit me numër protokoll 02-22 të datës 11.01.2022 të Ministrit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, rezulton se ankuesja është caktuar Zëvendësuese e Sekretares së Përgjithshëm në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. E njëjta në cilësi të zëvendësues së Sekretares se Përgjithshme përmes emailit zyrtar të datës 13.01.2022 ka kërkuar nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që të informohet përkitazi me rastin e shkeljes disiplinore *përdorimi i alkoolit gjatë orarit të punës*, dhe se rasti në fjalë a është adresuar pranë Komisionit Disiplinor.

Udhëheqësi i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme me datë 17.01.2022 ka njoftuar se ka shqiptuar vërejtje gojore ndaj zyrtareve të përfshirë në rastin në fjalë dhe i njëjti më datë 17.01.2022 ka iniciuar procedurë disiplinore në Komisionin Disiplinor. Ky i fundit më datë 10.02.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër protokoll 116-161 të datës 15.02.2022, me të cilin ka liruar nga përgjegjësia e shkelje së rëndë disiplinore [redacted] dhe [redacted] duke lënë në fuqi vërejtjen me gojë e shqiptuar nga Udhëheqësi i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, me arsyetim që pas deklaratave të iniciuesit të procedurës disiplinore, dëshmitarit dhe personave të përfshirë në rast dhe pas mungesës së provave të mjaftueshme nuk kemi mund të konstatojmë se janë përmbushur kushtet për aplikimin e dispozitës së nenit 49 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Vendimi me numër protokoll 116-161 i datës 15.02.2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, bazohet në konstatim të gabuar të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtas material dhe vlerësim jo drejt të provave materiale.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë konstatoi se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës Për Shërbimin Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës.



Se kush konsiderohet palë në procedurë administrative, Kolegji ju referua nenit 15 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sipas të cilit përcaktohet se: *Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenohet të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative. Ndërsa me nenin 124 po të njëjtit Ligj parashihet se: Pala ka të drejtë të ushtrojë mjete juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtar i një organi kolegjal, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjal, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë... Andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji vlerëson se me vendimin e kundërshtuar me ankesë, nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankueses, gjegjësisht ankesja nuk ka legjitimitetin e palës për të parashtruar ankesë kundër Vendimit me numër protokolli 116-161 të datës 15.02.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Kështu që bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhë se ankesa A.nr.148/2022 e datës 22.02.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted] është e papranueshme.*

Si me sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.148/2022

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

